**Vendim nr. 85, datë 29.09.2026**

**(V- 85/26)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 29.09.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Nj) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga deputeti Gazmend Bardhi dhe avokati Marash Logu, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Genci Gjonçaj dhe drejtorja e përgjithshme e Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit Institucional, Merita Qato.

**AVOKATI I POPULLIT,** në mungesë.

**OBJEKTI:** **Verifikimi i çështjes që lidhet me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit, përfshirë verifikimin e procedurës së zgjedhjes së shtetasit Endrit Shabani në këtë detyrë, si dhe konstatimi si e papajtueshme me Kushtetutën e Shqipërisë.**

**Shfuqizimi i vendimit nr. 111/2025, datë 11.12.2025 "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit" të Kuvendit të Shqipërisë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.**

**Pezullimi i vendimit nr. 111/2025, datë 11.12.2025 "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit" të Kuvendit të Shqipërisë**

**deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.**

**BAZA LIGJORE: Nenet 61, 75, 76, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 111 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, të ndryshuar; nenet 27, 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*); nenet 11, pika 3, shkronjat "c" dhe "f" dhe 27 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja e Gjykatës*); nenet 3, 4, 9 dhe 10 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar (*ligji nr. 8454/1999*).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 31.01.2023 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve*) i Kuvendit ka shpallur vakancën për pozicionin e Avokatit të Popullit. Në përfundim të afatit për paraqitjen e dokumentacionit kanë shprehur interesin për të kandiduar 15 kandidatë. Pas dëgjesës publike me kandidatët dhe pas vlerësimit të përmbushjes së kritereve kushtetuese e ligjore prej tyre, raporti i Komisionit të Ligjeve u është përcjellë deputetëve të Kuvendit për të vlerësuar mbështetjen e kandidatëve në kuptim të nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999. Megjithatë, kjo procedurë nuk u përfundua, për shkak se Kuvendi nuk kaloi për votim në seancë plenare kandidatët e kualifikuar.

2. Me vendimin nr. 2, datë 13.10.2025, pas fillimit të legjislaturës së re, Komisioni i Ligjeve ka shpallur sërish vakancën për pozicionin e Avokatit të Popullit. Në vijim, Kuvendi ka bërë shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen e tij zyrtare, në të cilën përfshihen kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, me afat deri në datën 03.11.2025, për paraqitjen e kandidaturave. Në përfundim të këtij afati kanë paraqitur interesin e tyre 26 kandidatë, mes të cilëve edhe Endrit Shabani.

3. Në mbledhjet e datave 12.11.2025 dhe 13.11.2025, Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar seancat dëgjimore me të gjithë kandidatët dhe në mbledhjen e datës 17.11.2025 ka miratuar listën e plotë të kandidatëve, së bashku me vlerësimin për përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Kjo listë, së bashku me vlerësimin e Komisionit të Ligjeve për përmbushjen e kritereve, me shkresën nr. 3352/2 prot., datë 17.11.2025, u është dërguar grupeve parlamentare dhe deputetëve jashtë këtyre grupeve. Sipas kësaj shkrese, bazuar në parashikimet e pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr. 8454/1999, kandidaturat për Avokat të Popullit i paraqiten Kuvendit me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe një deputet mund të mbështesë vetëm një kandidaturë. Për vijimin e procedurës Komisioni i Ligjeve ka përcjellë raportin e tij në mënyrë që të vlerësohej mbështetja e kandidatëve nga deputetët, e cila duhej të paraqitej brenda datës 02.12.2025.

4. Brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni i Ligjeve (datë 02.12.2025) kandidatët kanë paraqitur zyrtarisht në Kuvend listat mbështetëse të deputetëve, të cilat, pas përfundimit të këtij afati, i janë dërguar Komisionit të Ligjeve nga Kryetari i Kuvendit.

5. Me shkresën nr. 3853, datë 05.12.2025, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike (44 deputetë) i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit për tërheqjen e nënshkrimit (propozimit) dhe për pasojë të mbështetjes së deputetëve të këtij grupi parlamentar për kandidatët për Avokat të Popullit, duke revokuar nënshkrimin në të gjitha shkresat e protokolluara prej vetë kandidatëve pas kualifikimit nga Komisioni i Ligjeve. Sipas kësaj shkrese, mbështetja është dhënë përpara kualifikimit nga ai komision dhe vendimit të tij për zbatimin e parimit "një deputet mbështet vetëm një kandidat", ndërkohë që rezulton se një deputet ka propozuar/mbështetur më shumë se një kandidat, pavarësisht se ka vetëm një votë në Kuvend.

6. Në datën 09.12.2025 Komisioni i Ligjeve është mbledhur për shqyrtimin e plotësimit të kushteve ligjore për kandidatët që kanë marrë mbështetjen nga jo më pak se 28 deputetë. Në përfundim, Komisioni i Ligjeve ka vlerësuar se vetëm gjashtë kandidatë kanë paraqitur brenda afatit të caktuar numrin e nevojshëm të deputetëve mbështetës, të cilët do i dërgohen për votim seancës plenare.

7. Me urdhrin nr. 39, datë 09.12.2025, Kryetari i Kuvendit ka urdhëruar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 11.12.2025, ku në rendin e ditës është përfshirë edhe projektvendimi "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit".

8. Me shkresën nr. 3853/1 prot., datë 11.12.2025, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike (36 deputetë) i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, me kërkesë për tërheqjen e projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, i përfshirë në rendin e ditës të seancës plenare të kësaj date. Kërkesa është bazuar në faktin se nismëtarët për këtë projektvendim janë deputetët e këtij grupi parlamentar dhe ajo vjen në vijim të njoftimit për tërheqjen e mbështetjes për të gjithë kandidatët.

9. Në seancën plenare të datës 11.12.2025, për të njëjtat arsye si më sipër, nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është kërkuar mospërfshirja në rendin e ditës të projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke u shprehur edhe se kandidaturat zyrtare të Partisë Demokratike janë A.K. dhe B.N. Pas hedhjes në votim të kësaj kërkese, ajo është rrëzuar me shumicë të votave të deputetëve, për rrjedhojë projektvendimi "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit" ka vijuar të jetë pjesë e rendit të ditës.

10. Në përfundim të procesit të votimit për gjashtë kandidatët e kualifikuar, Endrit Shabani është zgjedhur Avokat i Popullit me 85 vota pro. Me vendimin nr. 111/2025, datë 11.12.2025 (*vendimi nr. 111/2025*), Kuvendi ka vendosur "Zgjedhjen e zotit Endrit Shabani Avokat të Popullit". Me vendimet nr. 106/2025, nr. 107/2025, nr. 108/2025, nr. 109/2025 dhe nr. 110/2025, datë 11.12.2025, Kuvendi ka vendosur moszgjedhjen e pesë kandidatëve të tjerë për Avokat të Popullit.

11. Në datën 18.12.2025 Avokati i Popullit ka bërë betimin në Kuvend dhe ka filluar ushtrimin e detyrës.

12. Në datën 12.01.2026 një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit të saj.

13. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 19.03.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, duke përcaktuar si subjekt të interesuar që do të thirrej në gjykim, Kuvendin.

## II

## Procesi në gjykimin kushtetues

14. Me vendimin e datës 26.03.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e vendimit nr. 111/2025 të Kuvendit, duke vlerësuar se nuk ka shkaqe nga ato që parashikon neni 45 i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kërkuesi nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin për mundësinë e ardhjes së pasojave të pariparueshme në interesat shtetërorë, shoqërorë ose të individëve. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e çështjes dhe të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi shqyrtimin e kësaj çështjeje me përparësi.

15. Me kërkesën e datës 18.05.2026, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjektit të interesuar, të shtetases A.K., për shkak se ajo ka kandiduar në këtë procedurë, ka marrë pjesë në seancën dëgjimore, ka mbledhur numrin e kërkuar të nënshkrimeve, si dhe ka paraqitur edhe ankim kushtetues për kundërshtimin e vendimit nr. 111/2025 të Kuvendit, çka dëshmon qasjen e saj proaktive dhe interesin në procedurën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, duke qenë kështu një subjekt drejtpërdrejt i interesuar për këtë gjykim kushtetues dhe për vendimmarrjen eventuale të Gjykatës.

16. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 21.05.2026, vendosi rrëzimin e kësaj kërkese, duke vlerësuar se, nga njëra anë, gjatë vendimmarrjes për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, Kolegji i Gjykatës ka vlerësuar si mënyrën e zhvillimit të seancës (mbi bazë dokumentesh), ashtu edhe subjektet që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen që shqyrtohet, në këtë rast Kuvendi, kurse nga ana tjetër, kërkuesi nuk ka arritur të provojë as interesin e vet subjektit për të qenë pjesë e gjykimit, as nevojën për thirrjen në gjykimin kushtetues. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vërejti se me vendimin nr. 60, datë 24.02.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare të kërkesës së paraqitur nga A.K. për kundërshtimin e procedurës së Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe shfuqizimin e vendimit të tij nr. 111/2025, duke vlerësuar se kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave të saj kushtetuese, për rrjedhojë nuk ka provuar interesin vetjak të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

17. Me kërkesën e datës 09.07.2026, e cila është regjistruar në Gjykatë në datën 13.07.2026, Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për vënien në dispozicion të akteve të kësaj çështjeje. Sipas Avokatit të Popullit, pasi ka marrë dijeni përmes njoftimeve në media për caktimin e datës së seancës plenare për shqyrtimin e çështjes, duke qenë se gëzon legjitimitet si subjekt i interesuar në këtë gjykim dhe me qëllim ushtrimin e së drejtës për të paraqitur qëndrimin e tij përpara Gjykatës, kërkon vënien në dispozicion të kërkesës, akteve shoqëruese të saj dhe të çdo akti tjetër, si dhe të qëndrimit të palëve në gjykimin kushtetues.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi fillimisht se kjo kërkesë ka për objekt të bashkëlidhur të saj edhe pjesëmarrjen e këtij subjekti si palë në gjykimin kushtetues. Sipas saj, në thelb, qëllimi i Avokatit të Popullit për t'u njohur me aktet e kësaj çështjeje lidhet pikërisht me pjesëmarrjen e tij në gjykimin kushtetues, me qëllim parashtrimin e qëndrimit të këtij subjekti për kërkimet dhe pretendimet e kërkuesit. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi e shqyrtoi kërkesën në kuptim të përmbajtjes së nenit 39, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, vlerësoi se, duke pasur parasysh objektin dhe pretendimet e çështjes kushtetuese në shqyrtim, pjesëmarrja e Avokatit të Popullit si subjekt i interesuar, me qëllim dëgjimin e tij, është jo vetëm në interesin e këtij subjekti, por edhe të vet këtij gjykimi kushtetues. Në këto kushte, me vendimin e datës 15.07.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi thirrjen në gjykimin kushtetues, në cilësinë e subjektit të interesuar, të Avokatit të Popullit, duke i njoftuar edhe të drejtat që gëzon si palë në gjykimin kushtetues, si dhe njoftimin e të gjitha palëve në gjykimin kushtetues për këtë vendim.

19. Në datën 03.09.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë plenare publike, duke parashtruar se shqyrtimi i kushtetutshmërisë së zgjedhjes së Avokatit të Popullit mbart interes të veçantë publik, pasi lidhet me respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe garantimin e mbrojtjes reale e efektive të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve. Sipas kërkuesit, pretendimet e ngritura në kërkesë kanë të bëjnë me një tërësi dispozitash kushtetuese dhe ligjore, të cilat duhet të trajtohen me kujdes të veçantë, duke iu dhënë mundësi palëve, por edhe qytetarëve e medias, që të njihen me materialet e çështjes, të dëgjojnë qëndrimet e palëve, pyetjet e Gjykatës dhe përgjigjet për to, debatin gjyqësor, si dhe vendimmarrjet e ndërmjetme e përfundimtare. Po sipas kërkuesit, informimi i publikut, transparenca e veprimtarisë dhe bashkëpunimi me median, si kushte themelore për të garantuar besimin e qytetarëve te institucionet dhe funksionarët e tyre, mund të realizohen vetëm përmes shqyrtimit të çështjes në seancë publike.

20. Në lidhje me këtë kërkesë, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka parashtruar se ajo është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet. Sipas Kuvendit, Kolegji i Gjykatës, në ushtrimin e kompetencës së përcaktuar nga Ligji Organik dhe Rregullorja e Gjykatës, ka marrë tashmë një vendim procedural për formën e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, duke ezauruar kështu edhe vlerësimin e tij diskrecionar për kriteret që lidhen me interesin e gjykimit kushtetues dhe interesin publik. Sipas tij, kërkuesi nuk ka identifikuar ndonjë rrethanë të re lidhur me interesin e gjykimit kushtetues dhe natyrën e çështjes, që do të bënte të nevojshme ndryshimin e formës së gjykimit, ndërsa rrethanat e evidentuara në kërkesë

janë çështje që mbartin të njëjtën peshë dhe rëndësi si në momentin e vlerësimit nga Kolegji i Gjykatës. Po sipas Kuvendit, shqyrtimi i çështjes mbi bazë dokumentesh plotëson kërkesat e procesit të rregullt, pasi kjo formë gjykimi u garanton palëve në mënyrë efektive të drejtat e tyre procedurale.

21. Subjekti tjetër i interesuar, Avokati i Popullit, në lidhje me këtë kërkesë të kërkuesit, ka parashtruar përpara Gjykatës se përcaktimi i modalitetit të shqyrtimit të çështjes përbën një prerogativë ekskluzive dhe diskrecionare, të cilën Gjykata e ushtron *ratione officii* në bazë të nenit 21, pika 1, të Ligjit Organik dhe nenit 26, pika 2, të Rregullores së saj, përmes një vlerësimi autonom të interesit të gjykimit kushtetues dhe të natyrës së çështjes. Avokati i Popullit e ka lënë në çmimin e Gjykatës vlerësimin për formën e shqyrtimit të kësaj çështjeje, duke kërkuar që ajo të bëhet në një kohë sa më të shkurtër në funksion të interesit publik dhe sigurisë juridike, për të evituar qëndrimin e zgjatur në një gjendje *sub judice* të mandatit të titullarit të një institucioni kushtetues.

22. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 22.09.2026, pasi mori në shqyrtim kërkesën dhe shkaqet e parashtruara nga kërkuesi, vlerësoi se ajo është e pabazuar. Bazuar në nenin 21, pika 1, të Ligjit Organik dhe nenin 5, pika 1, të Rregullores së Gjykatës, forma e këtij gjykimi është vendosur nga Kolegji i Gjykatës gjatë shqyrtimit të plotësimit të kritereve të pranueshmërisë së kërkesës kushtetuese, vendimmarrje gjatë së cilës është mbajtur në konsideratë edhe natyra e çështjes dhe e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se në shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në kërkesën për ndryshimin e formës së gjykimit nuk identifikohet ndonjë rrethanë e re, e patrajtuar nga Kolegji gjatë vendimmarrjes së tij dhe që mund të bëjë të nevojshme ose të domosdoshme ndryshimin e formës së gjykimit të kësaj çështjeje në seancë plenare publike. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se forma e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar, garanton parimet dhe standardet që lidhen me interesin publik, transparencën dhe gjykimin e drejtë e të plotë kushtetues të çështjes.

## III

## Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

23. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, në kërkesë dhe parashtrimet e tij, ka pretenduar:

23.1. Pretendimi se verifikimi i kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritës i përket vetëm Kuvendit është absurd, pasi: i) me këtë logjikë kërkohet të vendoset standardi që në organet kushtetuese ose institucionet e krijuara me ligj mund të zgjidhen individë që nuk përmbushin kriteret dhe një vendimmarrje e tillë nuk mund t'i nënshtrohet filtrit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë; ii) askush nuk është i pozicionuar më mirë për të vlerësuar se çfarë konsiderohen "njohuri dhe veprimtari të shquara në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit" sesa gjyqtarët kushtetues, të zgjedhur pikërisht për shkak të këtyre njohurive dhe veprimtarive.

23.2. Avokati i Popullit është zgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin nr. 8454/1999 dhe Rregulloren e Kuvendit, sepse ai nuk përmbushte kriteret kushtetuese dhe ligjore lidhur me: i) njohuritë dhe veprimtaritë e njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit; ii) mosqenien pjesë e ndonjë partie politike, duke qenë edhe në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin; iii) mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve. Sipas procesverbaleve të datave 12.11.2025, 17.11.2025 dhe 09.12.2025, Komisioni i Ligjeve nuk ka kryer një analizë të detajuar për përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe të meritës, por ka bërë vetëm një përmbledhje të biografisë së kandidatit, duke i marrë të mirëqena ato bazuar në pohimet e tij.

23.3. Për sa i përket kriterit të parë, sipas pikës 2 të nenit 61 të Kushtetutës, kandidati nuk ka të dokumentuar asnjë veprimtari të shquar ose në fushën e të drejtave të njeriut. Në dosjen e tij mungon dokumentacioni që provon eksperiencat si aktivist i shoqërisë civile, pjesëmarrjen në projekte ose bashkëpunimet me organizata ndërkombëtare, siç janë Transparency International, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Këshilli i Evropës dhe UN Women, angazhimin si pedagog dhe natyrën e këtij angazhimi, duke qenë se ky shtetas është diplomuar për drejtësi, ka kryer masterin shkencor për edukim dhe doktoraturën për politikë, pa një fushë të qartë specializimi dhe aq më pak në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit. Po kështu, ndonëse pretendon se është licencuar si avokat, në dosjen e kandidimit nuk ka ndonjë dokument provues.

23.4. Lidhur me kriterin e dytë, të parashikuar në pikën 4 të nenit 61 të Kushtetutës, nga dokumentet e administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se në datën 24.10.2025 partia "Nisma Thurje" ka paraqitur kërkesë për regjistrimin e dorëheqjes së Endrit Shabani nga pozicioni i

kryetarit të partisë dhe zgjedhjen e kryetarit të ri. Kërkesa është shqyrtuar nga gjykata në datën 12.11.2025 dhe në atë gjykim ka marrë pjesë edhe ky shtetas, i cili (sipas faqes 2 të procesverbalit) ka pranuar se është në kushtet e papajtueshmërisë, duke u shprehur: "*Formalisht unë figuroj si kryetar i partisë dhe më krijon kushte papajtueshmërie me një funksion ku po kandidoj*.". Qenia kryetar partie në kohën e kandidimit përbën kusht papajtueshmërie, rrethanë për të cilën ishte në dijeni edhe kandidati, pavarësisht se formalisht kishte paraqitur dorëheqjen. Vendimi nr. 15, datë 12.11.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë që ka pranuar kërkesën për regjistrimin e dorëheqjes së kryetarit të partisë ka marrë formë të prerë në datën 11.12.2025. Po kështu, me vendimin e datës 21.11.2025, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka vendosur pranimin e dorëheqjes së Endrit Shabani nga mandati i këshilltarit dhe me vendimin e datës 23.12.2025 ka vendosur t'i japë mandatin kandidatit të radhës. Kjo do të thotë se në datat 31.10.2025 (data e depozitimit të kandidaturës), 12.11.2025 (seanca dëgjimore), 17.11.2025 (miratimi i kandidaturave dhe vlerësimi i kritereve), 09.12.2025 (verifikimi i nënshkrimeve) dhe 11.12.2025 (dita e zgjedhjes), ky kandidat vazhdonte të figuronte si kryetar i partisë "Nisma Thurje" dhe anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, për shkak se mbetet i tillë deri në plotësimin e vakancës. Nëse Komisioni i Ligjeve do të kryente verifikimet e nevojshme do të duhej ta skualifikonte këtë kandidat nga gara. Edhe sipas përmbajtjes së procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 12.11.2025 në Komisionin e Ligjeve, disa deputetë kanë ngritur shqetësimin për njëanshmërinë politike të këtij kandidati për këtë shkak.

23.5. Nuk është plotësuar as kriteri i mbështetjes me jo më pak se 28 deputetë, sipas nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999 dhe nenit 111, pika 2, shkronjat "ç" dhe "d", të Rregullores së Kuvendit. Seancat dëgjimore me kandidatët janë zhvilluar në datat 12.11.2025 dhe 13.11.2025, megjithatë kandidatët kishin filluar mbledhjen e nënshkrimeve që më parë. Në datën 27.11.2025 kandidati Endrit Shabani ka paraqitur dy letra mbështetëse, njëra e nënshkruar nga 16 deputetë dhe tjetra nga 12 deputetë. Në datën 02.12.2025 ai ka paraqitur një tjetër letër mbështetëse me 7 deputetë. Megjithëse shumatorja e tre listave bën 35 deputetë, kandidati nuk ka arritur të ketë një listë unike mbështetjeje me 28 deputetë, edhe pse nga interpretimi logjik i nenit 9 të ligjit nr. 8454/1999 dhe i nenit 111 të Rregullores

së Kuvendit, për të zyrtarizuar një kandidaturë vullneti i deputetëve mbështetës duhet të materializohet në një akt të vetëm. Përtej elementeve formale, në datën 05.12.2025 deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike (44 deputetë) kanë tërhequr mbështetjen për të gjithë kandidatët për Avokat të Popullit, përfshirë Endrit Shabani, në respektim të vendimmarrjes së Komisionit të Ligjeve "*një deputet mbështet vetëm një kandidat*". Kjo do të thotë që në datën 09.12.2025, kur janë shqyrtuar nënshkrimet nga Komisioni i Ligjeve, ky kandidat nuk ka pasur asnjë deputet mbështetës të kandidaturës së tij, ndaj nuk mund të kualifikohej dhe nuk mund t'i kalonte seancës plenare për miratim. Në datën 11.12.2025 Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, në mbështetje të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar tërheqjen e projektvendimit "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit" dhe Kryetari i Kuvendit, në zbatim të neneve 75, pika 2, dhe 76, pika 1, të Kushtetutës, duhej ta kishte hequr këtë pikë nga rendi i ditës, duke qenë se ata ishin konsideruar si nismëtarët e këtij projektvendimi. Duke u lejuar vijimi i shqyrtimit dhe miratimi i këtij projektvendimi është vepruar në shkelje të Kushtetutës.

24. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** ka prapësuar si vijon:

24.1. Pretendimet e kërkuesit nuk arrijnë të provojnë cenimin e Kushtetutës, të ligjit nr. 8454/1999 dhe të Rregullores së Kuvendit. Kriteri i njohurive dhe veprimtarisë së njohur në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit është i karakterit cilësues-vlerësues dhe ligjvënësi ia ka besuar Komisionit të Ligjeve, si organi kompetent që e ka ushtruar këtë kompetencë përmes dëgjesave publike, vlerësimit individual të çdo kandidature dhe miratimit formal të listës së kandidatëve që plotësonin kriteret. Profili i kandidatit Endrit Shabani, me formim juridik, gradë shkencore, dekada angazhimi në shoqërinë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përvojë akademike në mësimdhënie dhe praktikë konstante të mbrojtjes së kauzave kushtetuese deri në Gjykatë, i përgjigjet standardit të meritës. Gjykata nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e meritës me një rivlerësim të vetin, përveçse në rastin e arbitraritetit të dukshëm, i cili nuk është provuar nga kërkuesi. Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar seanca dëgjimore publike me kandidatët dhe ka vlerësuar përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore, si dhe meritën e çdo kandidati përpara se raporti t'u përcillej deputetëve për fazën e mbështetjes. Endrit Shabani u dëgjua në seancën e datës 12.11.2025, me përfaqësues edhe të opozitës

parlamentare në komision, ku pati një prezantim të platformës dhe CV-së profesionale, si dhe pyetje nga deputetët për përgatitjen profesionale, funksionet e mbajtura deri në kohën e kandidimit dhe platformën e tij. Vlerësimi i këtij kriteri mbështetet mbi një bazë faktike të pasur dhe lehtësisht të verifikueshme. Pretendimi për interpretim të ngushtë të këtij kriteri, që do ta kthente në një filtër të rezervuar vetëm për një rreth të kufizuar profilesh profesionale, nuk gjen mbështetje kushtetuese e ligjore, madje do të binte ndesh me standardet ndërkombëtare, parimet e Venecies dhe të Parisit për institucionet e ombudsman-it.

24.2. Pretendimi për papajtueshmëri me funksionin për shkak të angazhimit politik të kandidatit nuk qëndron, pasi neni 61, pika 4, i Kushtetutës dhe neni 10 i ligjit nr. 8454/1999 i referohen ushtrimit të funksionit dhe jo periudhës së kandidimit. Kandidati ka paraqitur dorëheqjen e parevokueshme nga funksionet politike në kohën e aplikimit, edhe pse nuk ishte kusht detyrues dhe Komisioni i Ligjeve nuk kishte tagër verifikues për këtë element, pasi nuk përbën kusht skualifikimi. Fakti që 35 deputetë mbështetën këtë kandidat konfirmon se vlerësimi parlamentar përjashtonte ekzistencën e papajtueshmërisë në kohën e mbështetjes. Neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës bën një dallim të qartë midis çështjeve të "zgjedhshmërisë" dhe "papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve". Kërkuesi nuk ka vërtetuar se në momentin juridik të marrjes së mandatit (efektivisht pas datës 18.12.2025 kur kreu betimin), Avokati i Popullit vijonte të ushtronte një funksion politik ose bënte pjesë në një strukturë politike në kundërshtim me ndalimet kushtetuese dhe ligjore. Komisioni i Ligjeve ka administruar dokumentacionin sipas ligjit dhe ka kryer verifikimet përkatëse, sipas të cilave kandidati kishte paraqitur dorëheqjen nga funksionet politike përpara aplikimit, fakt që u bë i njohur edhe gjatë dëgjesës së datës 12.11.2025. Edhe sikur të ekzistonte një boshllëk i shkurtër kohor formal mes paraqitjes së dorëheqjes dhe regjistrimit administrativ të saj, kjo nuk do të sillte pasoja juridike për vlefshmërinë e zgjedhjes, pasi momenti relevant kushtetues është betimi në Kuvend.

24.3. Edhe pretendimi për mungesën e mbështetjes së vlefshme nga jo më pak se 28 deputetë dhe efektin rrëzues të tërheqjes së mëvonshme të mbështetjes nuk qëndron. Propozimi me mbështetje është akt procedural prekluziv dhe kjo

mbështetje depozitohet një herë, brenda afatit të caktuar, duke prodhuar efekt juridik të menjëhershëm në momentin e protokollimit. Pas mbylljes së afatit, as kandidati nuk mund të shtojë mbështetje, as deputeti nuk mund të tërheqë mbështetjen e dhënë. Po kështu, as ligji, as Rregullorja nuk kërkojnë "listë unike" mbështetjeje nga jo më pak se 28 deputetë, pra që ajo të materializohet në një akt të vetëm. Propozimi është akt formal-procedural dhe jo politik dhe vota në seancë plenare është shprehja politike përfundimtare e deputetit. Pas mbylljes së afatit, kandidati fiton një status procedural të mbrojtur, ndaj revokimi *post factum* është juridikisht i paefektshëm, pasi synon të ndryshojë me efekt prapaveprues, në mënyrë arbitrare, një gjendje juridike të konsoliduar. Deputeti që ka dhënë mbështetjen ruan lirinë politike për të votuar pro, kundër ose për të abstenuar në momentin e votimit në seancë. Në rastin konkret, deputetët e pakicës parlamentare mbështetën kandidatin e zgjedhur, duke konstatuar institucionalisht përmbushjen e kritereve kushtetuese të zgjedhshmërisë dhe të meritës profesionale, çka ka prodhuar efekte juridike të menjëhershme dhe të pakthyeshme. Sjellja kundërshtuese e mëvonshme, siç është paraqitja e kërkesës përpara Gjykatës për kundërshtimin e zgjedhshmërisë të të njëjtit kandidat, përbën një rast klasik të zbatimit të parimit *nemo potest venire contra factum proprium*. Ky pretendim përveçse juridikisht i papranueshëm dhe me kontradiktë logjike, përbën edhe një rast të abuzimit me të drejtat procedurale.

24.4. Për sa i përket zbatimit të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, ai rregullon "procedurën ligjvënëse" dhe nuk mund të aplikohet me analogji në "procedurën e zgjedhjes", për shkak të dallimeve sistematike thelbësore midis akteve që rezultojnë nga këto procedura (në rastin e parë, me karakter normativ dhe në të dytin, me karakter individual), shkak për të cilin janë rregulluar veçmas. Parimi "një deputet një kandidat" parashikohet vetëm në nenin 6, pika 1, të Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit të tij, por nuk mund të zgjerohet përmes interpretimit në procedurat e tjera. Komisioni i Ligjeve, duke përcjellë në seancë plenare gjashtë kandidatura të cilat plotësonin kushtin numerik, ka konfirmuar se ky parim nuk është aplikuar si filtër përjashtues dhe nuk është detyrues. Nëse ky parim do të kishte qenë normë juridike detyruese, atëherë do të ishin përjashtuar të gjitha rastet e mbështetjeve të dyfishta dhe rezultati do të ishte i ndryshëm.

24.5. I pabazuar është edhe pretendimi për shkelje të neneve 75 dhe 76 të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit. Asnjë normë e Kushtetutës ose e Rregullores nuk parashikon kompetencën automatike të tij për të hequr nga rendi i ditës projektvendimin pas tërheqjes së mbështetjes. Kjo kërkesë u paraqit, u debatua dhe u hodh në votim në seancë plenare, e cila e rrëzoi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm. Vijimi i procedurës dhe lejimi i shprehjes së vullnetit përfundimtar të Kuvendit përputhen me natyrën parlamentare të vendimmarrjes dhe me kompetencën kushtetuese të këtij organi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Nuk ka shkelje të qartë e të drejtpërdrejtë të Kushtetutës, mungesë të garancive themelore procedurale, cenim të kompetencave kushtetuese të organeve të tjera ose arbitraritet në vendimmarrjen parlamentare. Kandidati ka vepruar në mirëbesim, duke u mbështetur në rregullat e shpallura nga Komisioni i Ligjeve, ka përmbushur brenda afatit kushtin ligjor të depozitimit të mbështetjes nga 28 deputetë dhe ka fituar të drejtën procedurale për t'iu nënshtruar votimit. Çdo ndërhyrje *post factum* që rëndon pozitën e tij procedurale do të zhbënte një fakt procedural të certifikuar dhe do të shkelte të drejtat e fituara në mirëbesim.

25. ***Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim për themelin e çështjes, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata. Në parashtrimet e tij me shkrim lidhur me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare publike, ky subjekt është shprehur edhe se pozicioni i tij në këtë gjykim është i dyfishtë, si subjekt i interesuar, në kuptim të ligjit procedural dhe, mbi të gjitha, si titullar i një institucioni kushtetues, të cilin Kushtetuta e ka konceptuar të pavarur në ushtrimin e detyrës dhe që ushtron funksionin duke qëndruar në distancë të barabartë nga aktorët e këtij procesi. Ndërmjet këtyre dy cilësive, Avokati i Popullit ka gjykuar se parimi i luajalitetit kushtetues dhe i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kushtetuese shprehet më së miri përmes vetëpërmbajtjes së vetëdijshme të tij nga pjesëmarrja në gjykim dhe përmes besimit te Gjykata për vlerësimin e kësaj çështjeje.

## IV

## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*A. Për juridiksionin e Gjykatës*

26. Kërkuesi (jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit) i është drejtuar Gjykatës për verifikimin e çështjes së zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e

funksioneve të Avokatit të Popullit, përfshirë verifikimin e procedurës së zgjedhjes së tij nga Kuvendi, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit nr. 111/2025 të marrë në përfundim të kësaj procedure parlamentare. Për rrjedhojë, bazuar në objektin e kërkesës dhe shkaqet e parashtruara në mbështetje të saj, Gjykata vuri fillimisht në diskutim çështjen e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

27. Neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës parashikon se Gjykata vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Përmbajtja e kësaj dispozite nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së këtyre funksionarëve publikë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se kontrolli kushtetues kufizohet vetëm ndaj funksionarëve të organeve të parashikuara nga Kushtetuta (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kontrolli kushtetues për këto çështje ka natyrë individuale, pasi bazohet në vlerësimin e shkeljes konkrete për ato ndalime kushtetuese ose ligjore që prekin zgjedhshmërinë, papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit kushtetues ose procesin e zgjedhjes ose emërimit të funksionarit të identifikuar. Në çështjet e përfshira në rregullimin e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131, jo vetëm që bëhet fjalë për individin që merr funksion zyrtar, por qëllimi i saj është mbrojtja e interesit publik që në organe të parashikuara nga Kushtetuta funksionarët të zgjidhen sipas procedurave përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë dhe pajtueshmërisë me funksionin. Në lidhje me togfjalëshin "verifikimin e zgjedhjes së tyre" në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai duhet të interpretohet në kuptimin që ka të bëjë me verifikimin e respektimit të së drejtës individuale për t'u zgjedhur të funksionarit të organit kushtetues gjatë procesit zgjedhor (*shih vendimet nr. 71, datë 12.11.2025; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren, *së pari*, se kërkuesi ka identifikuar funksionarin publik, Avokatin e Popullit, të zgjedhur me vendimin nr. 111/2025 të Kuvendit, i cili, bazuar në parashikimet e neneve 60 deri 63 të Kushtetutës, që përcaktojnë funksionin, kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes, si edhe garancitë e tij kushtetuese, përfshihet në kategorinë e funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë. Për rrjedhojë, çështjet që lidhen me

zgjedhshmërinë, papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit dhe verifikimin e zgjedhjes së këtij funksionari përfshihen në juridiksionin kushtetues.

30. *Së dyti,* në aspektin material, referuar shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vëren se ai ka kërkuar verifikimin e shkeljeve konkrete të kryera nga Kuvendi në këtë procedurë, për sa kohë që pretendohet se Avokati i Popullit është zgjedhur në mungesë të plotësimit të kritereve kushtetuese e ligjore nga kandidati, si dhe në prani të ndalimeve kushtetuese, të cilat përbëjnë shkak për konstatimin e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe se vetë procedura e ndjekur nga Kuvendi për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për zgjedhjen e këtij funksionari është zhvilluar në shkelje të dispozitave të ligjit organik të Avokatit të Popullit dhe të Rregullores së Kuvendit, duke cenuar edhe të drejtat e deputetit që burojnë nga mandati i tij përfaqësues. Kërkuesi ka kundërshtuar edhe aktin konkret që ka materializuar shkeljet e pretenduara, që është vendimi nr. 111/2025 i Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

31. Për sa më sipër, Gjykata vëren se *prima facie* çështja e parashtruar përpara saj bën pjesë në juridiksionin kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës.

*B. Për kriteret e tjera të pranueshmërisë së kërkesës*

32. *Sipas kërkuesit,* edhe pse dispozitat e posaçme të Ligjit Organik të Gjykatës përmbajnë rregullime vetëm për rastet e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës nga Presidenti i Republikës dhe deputetët e Kuvendit, por jo për ato të funksionarëve të tjerë publikë, kjo nuk nënkupton se një e pesta e deputetëve nuk ka të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën edhe në këto raste. Kurse *subjekti i interesuar, Kuvendi,* nuk ka ngritur prapësime në këtë drejtim.

33. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të legjitimimit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

34. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar kontrollin kushtetues të aspekteve procedurale dhe materiale të procedurës parlamentare të zhvilluar për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se juridiksioni kushtetues është i lidhur ngushtësisht edhe me natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura

(*shih vendimet nr. 8, datë 21.02.2025; nr. 34, datë 24.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke vlerësuar se elementet përcaktuese të juridiksionit të saj kushtetues janë natyra e të drejtave që vihen në diskutim, të cilat duhet të jenë të tilla që burojnë nga normat kushtetuese, si dhe pasojat që vijnë në këto të drejta, u ndal në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në lidhje me ato aspekte të procedurës parlamentare që lidhen me mënyrën e formën e mbështetjes së kandidatëve, si dhe me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të Rregullores së Kuvendit gjatë procedurës parlamentare të kundërshtuar.

35. Jurisprudenca kushtetuese, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, ka theksuar se mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera kjo nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimet nr. 54, datë 09.07.2024; nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Një pjesë e normave të Rregullores kanë përmbajtje të njëjtë ose detajojnë normat kushtetuese dhe, për këtë shkak, marrin natyrë të veçantë e mund të sjellin edhe pasoja të nivelit kushtetues. Pa vënë në diskutim pavarësinë e Kuvendit si organi që miraton dhe interpreton Rregulloren në ushtrim të pushtetit vetërregullues sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, kompetenca e Gjykatës kufizohet vetëm në pretendime kushtetuese dhe ushtrohet ndaj atyre dispozitave që prekin normat kushtetuese (*shih vendimet nr. 18, datë 23.02.2026; nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kuvendi gëzon një shkallë të gjerë lirie për të vendosur për rregullat që kërkohen me qëllim vetorganizimin, në mënyrë që të garantojë kryerjen e duhur të punëve. Megjithatë, kufiri ndërmjet dy parimeve të dallueshme, atij të autonomisë së Kuvendit dhe atij të kushtetutshmërisë, ku ky i fundit detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, vihet nën mbrojtjen e kësaj Gjykate, e cila mund dhe duhet të vihet në lëvizje sa herë përpara saj paraqiten për zgjidhje mosmarrëveshje kushtetuese për shkak të cenimit të parimeve kushtetuese dhe të lirive themelore (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata, në kuptim të sa më sipër, vlerëson se pretendimet e kërkuesit për: i) *nënshkrimet e 28 deputetëve mbështetës në një listë të vetme*; ii) *mënyrën e zbatimit të rregullit të brendshëm "një deputet mbështet vetëm një kandidat"*; iii) *interpretimin e nenit 72 të Rregullores së Kuvendit për tërheqjen nga rendi i ditës të projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit*; iv) *ekzistencën e marrëveshjes politike mes shumicës dhe pakicës parlamentare sipas së cilës Avokati i Popullit duhet të vijë si kandidat i pakicës parlamentare,*

nuk ngrenë, sipas kërkimeve dhe shkaqeve të parashtruara, ndonjë çështje të nivelit kushtetues që të justifikojë ushtrimin e kontrollit kushtetues, për arsyet që vijojnë.

37. Për sa i përket pretendimit për paraqitjen e 28 nënshkrimeve të deputetëve në një listë të vetme, unike, Gjykata vëren se sipas nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999, kandidaturat për Avokat të Popullit i paraqiten Kuvendit me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë, të përzgjedhur në radhët e kandidatëve që përmbushin kriteret kushtetuese e ligjore dhe meritën, sipas vlerësimit të komisionit që mbulon çështjet ligjore, në listën e miratuar prej tij. Sipas nenit 111, pika 2, shkronja "d", të Rregullores së Kuvendit (në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj procedure) kandidaturat që marrin mbështetjen nga jo më pak se 28 deputetë depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në këtë nen. Ndërsa paraqitja e mbështetjes me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë është kusht ligjor për kalimin e kandidatit për votim në seancë plenare, aspektet formale që lidhen me formën dhe mënyrën e paraqitjes së këtyre nënshkrimeve, pra në një dokument të vetëm ose në më shumë të tillë, janë çështje që lidhen me organizimin e brendshëm të procedurës parlamentare dhe, si të tilla, i përkasin autonomisë parlamentare. Për sa kohë që kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se si lidhet ky aspekt i procedurës parlamentare me cenimin e ndonjë parimi ose të drejte kushtetuese, ai nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues.

38. Për sa i përket pretendimit për moszbatimin e rregullit "*një deputet mbështet vetëm një kandidat*", Gjykata vëren se ndonëse ai nuk gjente rregullim të shprehur në dispozitat në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj procedure parlamentare, është artikuluar si i tillë nga Komisioni i Ligjeve në shkresën me të cilën u ka dërguar grupeve parlamentare dhe deputetëve jashtë këtyre grupeve listën e kandidatëve që plotësonin kriteret kushtetuese e ligjore. Referuar parashikimeve të Rregullores së Kuvendit një rregull i tillë parashikohet në nenin 6, pika 1, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe në vijim, me vendimin nr. 83/2026 të Kuvendit "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", ai është përfshirë edhe në përmbajtjen e nenit 111/1, të shtuar, i cili rregullon procedurën e zgjedhjes në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të një grupi deputetësh. Megjithatë, këto ndryshime të Rregullores janë miratuar nga Kuvendi me vendimin e datës 21.05.2026, pra disa muaj pas zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë, në kohën e paraqitjes së nënshkrimeve mbështetëse të deputetëve Rregullorja e Kuvendit nuk përmbante një parashikim ndalues të shprehur për numrin e kandidatëve që mund të mbështeste një deputet. Nga ana tjetër, as vetë Komisioni i Ligjeve në momentin e verifikimit të nënshkrimeve mbështetëse pas

përfundimit të afatit për dorëzimin e tyre, as deputetët gjatë paraqitjes së mbështetjes së tyre dhe as vetë seanca plenare nuk janë ndalur në verifikimin e zbatueshmërisë ose detyrueshmërisë së një standardi të tillë, edhe pse dukshëm, duke pasur parasysh numrin e deputetëve të Kuvendit (140), numrin e kandidatëve që kishin siguruar mbështetjen e nevojshme (6) dhe numrin e nevojshëm të deputetëve për mbështetje (28), rezulton se të paktën disa deputetë duhet të kenë mbështetur më shumë se një kandidat. Për rrjedhojë, në situatën që një rregull i tillë nuk ishte i parashikuar shprehimisht nga Rregullorja për këtë procedurë dhe as përcaktoheshin pasojat procedurale të mbështetjes së shumëfishtë, mënyra se si është vepruar në rastin konkret ngre vetëm çështje të organizimit dhe praktikës së brendshme parlamentare dhe jo çështje me natyrë kushtetuese.

39. Për sa i përket çështjes që ka të bëjë me zbatimin e nenit 72 të Rregullores për tërheqjen e aktit (projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit), të lidhur edhe me nenet 75, pika 2, dhe 76, pika 1, të Kushtetutës, që parashikojnë se Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores dhe se Kryetari siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe anëtarëve të tij, Gjykata vëren se parashikimet përkatëse të Rregullores së Kuvendit, mbi të cilat kërkuesi ka mbështetur këtë pretendim, rregullojnë veprimtarinë që lidhet me *funksionin ligjvënës* të Kuvendit (miratimi i ligjeve dhe plotësimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për funksionimin demokratik të shtetit dhe jetës shoqërore). Procedura për emërimin, zgjedhjen dhe shkarkimin e organeve kushtetuese me propozim të deputetëve, e cila lidhet me ushtrimin e *funksionit zgjedhës* të Kuvendit *(*zgjedhja e disa prej funksionarëve më të lartë të shtetit) rregullohet nga Pjesa e Pestë e Rregullores së Kuvendit. Për rrjedhojë, për sa kohë që neni 72 i Rregullores rregullon procedurën ligjvënëse dhe jo procedurën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin konkret.

40. Kërkuesi ka pretenduar edhe se Avokati i Popullit duhej të ishte "kandidat i pakicës parlamentare" për shkak të marrëveshjes politike të lidhur mes palëve. Gjykata thekson se ekzistenca e një marrëveshjeje me natyrë politike dhe mungesa e materializimit të saj nuk mund të përbëjë një çështje me natyrë kushtetuese për sa kohë që një akt i tillë me natyrë politike nuk krijon, pa një mbështetje përkatëse normative, të drejta kushtetuese dhe as mund të shërbejë për t'i dhënë bazë kushtetuese kërkimeve që mund të lindin nga një marrëveshje e tillë.

41. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk paraqesin, në mënyrën sesi janë ngritur, një mosmarrëveshje me natyrë kushtetuese, pra që të ngrenë çështje të mosrespektimit të normave dhe parimeve kushtetuese, si të vetmet shkaqe që mund të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

42. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vëren se ato kanë të bëjnë jo vetëm me meritën e kandidatit të zgjedhur, por edhe me ushtrimin prej tij të funksioneve e veprimtarive me natyrë politike. Në lidhje me institutet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë, Gjykata ka theksuar se pazgjedhshmëria synon të ndalojë një kandidat të caktuar që të mund të emërohet në një funksion publik ose të fitojë një mandat nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në zgjedhje, kurse papajtueshmëria ka të bëjë me ndërprerjen e funksionit ose mandatit në rast se verifikohen shkaqe që nuk lejojnë ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të tij. Në çdo rast, si shkak pazgjedhshmërie ose papajtueshmërie shërbejnë fakte, rrethana ose sjellje që ndalojnë emërimin ose zgjedhjen, ose bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit publik, të cilat mund të jenë të parashikuara nga norma kushtetuese ose në ligje të veçanta (*shih vendimet nr. 71, datë 12.11.2025; nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Gjykata vëren se këto pretendime të kërkuesit, për nga mënyra se si janë parashtruar, kanë të bëjnë me dy institute të ndryshme. Pretendimi për plotësimin e kushtit të meritës së kandidatit ka të bëjë me çështje të zgjedhshmërisë së funksionarit publik, në kuptim të pikës 2 të nenit 61 të Kushtetutës. Për sa i përket ushtrimit të funksionit politik nga kandidati i zgjedhur Avokat i Popullit, kërkuesi ka pretenduar se edhe ky përbën, gjithashtu, një kusht pazgjedhshmërie, i cili duhej të ishte konstatuar më së pari nga Komisioni i Ligjeve gjatë verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve kushtetuese e ligjore. Gjykata vëren se sipas pikës 4 të nenit 61 të Kushtetutës, Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike ose të kryejë veprimtari tjetër politike. Neni 61, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 3 i ligjit nr. 8454/1999, të cilët parashikojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit, nuk vendosin si kusht për kandidim mosqenien anëtar/drejtues partie ose mosushtrimin e ndonjë veprimtarie politike ose me natyrë tjetër në momentin e kandidimit. Është e vërtetë se në shpalljen e pozicionit vakant për Avokat të Popullit është përcaktuar ftesa për të kandiduar për kandidatët që nuk bëjnë pjesë në parti ose organizata politike, nuk kryejnë veprimtari tjetër politike, shtetërore e profesionale dhe nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare, megjithatë, një kriter i tillë përjashtues, në ndryshim nga funksionarë të tjerë, siç janë gjyqtarët, për të cilët Kushtetuta kërkon që të mos kenë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit, nuk parashikohet në lidhje me këtë funksionar publik nga Kushtetuta, ligji organik i Avokatit të Popullit dhe vetë Rregullorja e Kuvendit. Ndërkohë, sipas nenit 61, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 10 të ligjit nr. 8454/1999, pjesëmarrja në parti politike dhe ushtrimi i

disa veprimtarive të tjera politike, shtetërore ose profesionale përbëjnë shkak për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit do të verifikohet nga Gjykata në këndvështrim të papajtueshmërisë me funksionin kushtetues, pra nëse Avokati i Popullit gjatë ushtrimit të detyrës ka ushtruar njëkohësisht veprimtari të tjera të papajtueshme me funksionin kushtetues.

44. Kërkuesi ka pretenduar edhe antikushtetutshmërinë e procedurës së zhvilluar nga Kuvendi për kalimin e gjashtë kandidaturave për votim në seancë plenare dhe zgjedhjen e Avokatit të Popullit pavarësisht se deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kishin tërhequr mbështetjen e tyre. Gjykata vëren se shkronja "e" e pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës parashikon jo vetëm papajtueshmërinë dhe pazgjedhshmërinë e funksionarëve publikë, por edhe zgjedhjen e tyre, që do të thotë verifikimin e aspekteve të procedurës së zhvilluar për këtë qëllim. Sipas nenit 6 të Kushtetutës, organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata ka theksuar se Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore e politike të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se pretendimi për mbështetjen e kandidatit me një numër minimal deputetësh ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të një kushti ligjor, i cili parashikohet si i tillë në ligjin organik të Avokatit të Popullit dhe Rregulloren e Kuvendit. Për sa kohë që plotësimi i këtij kushti është parashikuar si një aspekt i procedurës për zgjedhjen e funksionarit publik, ai ka të bëjë me çështje të verifikimit të zgjedhjes në kuptim të shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës.

45. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet e kërkuesit, si më sipër, kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të procedurës parlamentare të kundërshtuar, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë ato veçmas.

*C. Për themelin e pretendimeve*

46. Gjykata, përpara vlerësimit në themel të kësaj çështjeje, vlerëson të theksojë, fillimisht, se Kushtetuta e ka përfshirë institucionin e Avokatit të Popullit në Pjesën e Dytë të saj, të titulluar "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", ku janë parashikuar parimet e përgjithshme, të drejtat dhe liritë kushtetuese të individit. Kjo zgjedhje e ligjvënësit kushtetues

nuk është e rastësishme dhe lidhet me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetasve, të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik (*shih vendimet nr. 14, datë 17.04.2013; nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Avokati i Popullit, sipas pikës 1 të nenit 60 të Kushtetutës, mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, duke u konceptuar kështu si garancia institucionale e individit përballë veprimtarisë së këtyre organeve të pushtetit publik. Kjo garanci shtesë i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike duke pasur Avokati i Popullit edhe të drejtën që t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse që të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve apo të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla (*shih vendimet nr. 20, datë 04.04.2014; nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këto arsye, me ndryshimet e vitit 2016 ligjvënësi kushtetues e përfshiu këtë subjekt në rrethin e atyre që, sipas nenit 134 të Kushtetutës, kanë legjitimitet të pakushtëzuar për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

47. Edhe sipas Parimeve të Venecies (*shih Opinionin e Komisionit të Venecies CDL-AD(2019)005, datë 03.05.2019 "Parimet për mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve të Ombudsman-it"*), institucionet e ombudsman-it kanë një rol të rëndësishëm në forcimin e demokracisë, shtetit të së drejtës, administrimit të mirë dhe mbrojtjes e promovimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sipas këtij opinioni, këto institucione, përfshirë mandatin e tyre, duhet të mbështeten në një bazë ligjore të qëndrueshme, e preferueshme në nivel kushtetues dhe ombudsman-i duhet të zgjidhet dhe emërohet në përputhje me një procedurë që forcon sa më shumë të jetë e mundur autoritetin, paanshmërinë, pavarësinë dhe legjitimitetin e këtij institucioni.

48. Për sa më sipër, natyra e funksionit kushtetues të Avokatit të Popullit përcakton edhe garancitë kushtetuese që ai gëzon, të cilat lidhen me natyrën e kushteve dhe kritereve për zgjedhjen e tij, me procedurën e shkarkimit, si dhe pavarësinë në ushtrimin e detyrës dhe atë institucionale. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kushtet dhe kriteret që rregullojnë çështjet e zgjedhshmërisë, papajtueshmërisë me funksionin dhe procedurën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit nuk janë kërkesa formale, por garanci kushtetuese të lidhura drejtpërdrejt me misionin kushtetues të këtij institucioni.

*C.1. Për zgjedhshmërinë e Avokatit të Popullit*

49. *Sipas kërkuesit,* Avokati i Popullit është zgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin nr. 8454/1999 dhe Rregulloren e Kuvendit, sepse ai nuk përmbushte kriterin kushtetues të njohurive dhe veprimtarive të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, ndërkohë që Komisioni i Ligjeve nuk ka kryer një analizë të detajuar në këtë drejtim, por ka bërë vetëm një përmbledhje të biografisë së kandidatit, duke e marrë të mirëqenë plotësimin e këtij kushti bazuar vetëm në pohimet e tij. Kandidati i zgjedhur, vijon kërkuesi, nuk ka të dokumentuar asnjë veprimtari të shquar ose në fushën e të drejtave të njeriut dhe në dosjen e tij mungon dokumentacioni që provon eksperiencat si aktivist i shoqërisë civile, pjesëmarrjen në projekte ose bashkëpunimet me organizata ndërkombëtare. Po sipas kërkuesit, kandidati nuk ka asnjë dokument provues për sa i përket angazhimit si pedagog lidhur me natyrën e këtij angazhimi, duke qenë se është diplomuar për drejtësi, ka kryer masterin shkencor për edukim dhe doktoraturën për politikë, pra pa një fushë të qartë specializimi dhe aq më pak në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, sikundër nuk ka një dokument provues për licencimin e pretenduar prej tij si avokat.

50. *Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit,* kriteri i njohurive dhe veprimtarisë së njohur në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit është i karakterit cilësues-vlerësues dhe ligjvënësi ia ka besuar Komisionit të Ligjeve si organi kompetent, i cili e ka ushtruar këtë kompetencë përmes dëgjesave publike, vlerësimit individual të kandidaturave dhe miratimit formal të listës së kandidatëve që plotësonin kriteret. Gjykata nuk mund të bëjë një rivlerësim të sajin në këtë drejtim, përveçse në rastin e arbitraritetit të dukshëm, i cili nuk është provuar nga kërkuesi. Sipas këtij subjekti, profili i kandidatit të zgjedhur, me formim juridik, gradë shkencore, dekada angazhimi në shoqërinë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përvojë akademike në mësimdhënie dhe praktikë edhe në mbrojtjen e çështjeve kushtetuese, i përgjigjet standardit të meritës. Po sipas tij, kandidati është dëgjuar nga Komisioni i Ligjeve në seancë dëgjimore publike, me përfaqësues edhe të opozitës parlamentare, ku u prezantua platforma dhe karriera profesionale dhe iu drejtuan edhe pyetje nga deputetët për përgatitjen profesionale e funksionet e mbajtura deri në atë kohë. Sipas Kuvendit, vlerësimi i këtij kriteri mbështetet mbi një bazë faktike të identifikueshme dhe lehtësisht të verifikueshme.

51. Gjykata vëren se sipas pikës 2 të nenit 61 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë dhe me "njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit". Kurse sipas nenit 3 të ligjit nr. 8454/1999, Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar që plotëson edhe kushtin që të ketë "njohuri dhe

veprimtari të shquara në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit". Gjykata vëren se për shkak të rëndësisë së funksionit kushtetues të Avokatit të Popullit, qëllimi i parashikimit të një kushti të tillë është që të garantohet që kandidatët e ofruar të zotërojnë njohuritë dhe përvojën e nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrave kushtetuese, duke përbërë ai një kusht thelbësor, respektimi i të cilit duhet të sigurohet gjatë procedurës parlamentare.

52. Gjykata konstaton, fillimisht, se Kushtetuta dhe ligji organik i Avokatit të Popullit nuk përdorin formulime identike për vlerësimin e kriterit të meritës nga kandidatët. Ndërsa norma kushtetuese përdor termin "njohuri dhe veprimtari të njohura", norma ligjore shprehet për "njohuri dhe veprimtari të shquara" të kandidatëve. Pavarësisht këtij dallimi në terminologji, të dyja këto parashikime i referohen domosdoshmërisë që kandidati të ketë njohuri dhe një veprimtari të spikatur në fushat e të drejtave të njeriut dhe të ligjit. Megjithatë, kërkuesi, në thelb, nuk vë në diskutim mënyrën se si janë interpretuar këto dispozita nga Kuvendi ose organet e tij, por mënyrën se si është provuar nga kandidati plotësimi i këtij kushti, pra ekzistenca e njohurive dhe e kontributit në fushat specifike të të drejtave të njeriut dhe të ligjit, si dhe mënyrën se si është verifikuar respektimi i këtij kushti nga Kuvendi. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh pretendimet e palëve dhe natyrën e kontrollit kushtetues, Gjykata çmon të ndalet në kufijtë e këtij kontrolli.

53. Lidhur me sa më sipër, Gjykata vlerëson se mënyra e interpretimit të kushteve për zgjedhjen e një funksionari publik nuk mund të bëhet në çdo rast e për çdo shkak objekt i kontrollit kushtetues. Në kuptim të parimit të autonomisë parlamentare, por edhe të parimit të ndarjes së pushteteve, vlerësimi i meritës së kandidatëve është një çështje që i takon Kuvendit, i cili ka diskrecionin për të vlerësuar edhe rëndësinë dhe peshën që kanë njohuritë, përvoja dhe veprimtaritë e secilit kandidat në raport me funksionin kushtetues për të cilin ai kandidon. Megjithatë, bazuar në parimin e kushtetutshmërisë, diskrecioni i Kuvendit në këtë procedurë nuk është i pakufizuar dhe ai i nënshtrohet kontrollit kushtetues në kuptim të përmbajtjes së shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, nëse ushtrohet në mënyrë arbitrare. Ekzistenca e hapësirës së vlerësimit të meritës së kandidatëve nuk nënkupton se Kuvendi mund të shmangë verifikimin e kushteve dhe kritereve kushtetuese të zgjedhshmërisë, përndryshe, ato do të mbeteshin thjesht kërkesa formale, respektimi i të cilave do të varej nga vullneti i atij organi.

54. Për sa i përket hapësirës së saj të kontrollit, Gjykata vlerëson se verifikimi i respektimit të kushteve të zgjedhshmërisë dhe vlerësimit të kritereve të meritës së kandidatëve janë dy aspekte të dallueshme, ku i pari lidhet me respektimin nga Kuvendi të kufijve të tij

gjatë procedurës parlamentare për zgjedhjen e funksionarit publik, kurse i dyti me vlerësimin e të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni provues i paraqitur nga kandidatët. Në këtë vlerësim të meritës, Gjykata nuk mund të zëvendësojë Kuvendin, pra të përcaktojë ajo vetë se cilat veprimtari profesionale duhet të konsiderohen më të rëndësishme, peshën që duhet t'u jepet aspekteve të caktuara të arsimimit, përvojës profesionale ose angazhimeve të kandidatëve në fushat përkatëse të të drejtave të njeriut dhe të ligjit. Përndryshe, Gjykata do të tejkalonte kufijtë e juridiksionit të saj kushtetues duke ushtruar një kompetencë që i është njohur ekskluzivisht organit të emërtesës, Kuvendit. Nga ana tjetër, vlerësimi i Gjykatës nuk mund të jetë as formal, por ai ndalet në verifikimin e garancive procedurale të cilat synojnë të garantojnë që procedura parlamentare të mos jetë arbitrare. Gjykata verifikon nëse vlerësimi i Kuvendit ka pasur një mbështetje faktike të identifikueshme, pra nëse në aktet e procedurës parlamentare ekzistojnë fakte objektive të cilat japin të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kandidatët plotësojnë kushtet dhe kriteret për kandidim. Për këtë qëllim merr rëndësi verifikimi i ekzistencës së atij dokumentacioni që jep të dhëna objektivisht të verifikueshme për plotësimin e këtij kushti, pra se Kuvendi nuk është mbështetur në deklarime formale të kandidatëve ose të pambështetura me dokumentacionin provues. Gjykata nuk përcakton nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i aftë të provojë një nivel të caktuar të meritës së tyre, por vetëm nëse ai ka siguruar një bazë faktike, të mjaftueshme për Kuvendin, me qëllim ushtrimin e kompetencës së tij kushtetuese.

55. Vetë kërkuesi e ka lidhur pretendimin e tij me mungesën e dokumentacionit që provon veprimtaritë e deklaruara nga kandidati në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, konkretisht ato që provojnë veprimtarinë si aktivist të shoqërisë civile, pjesëmarrjen në projekte ose bashkëpunimet me organizata ndërkombëtare, natyrën e angazhimit të tij si pedagog, fushën e tij të specializimit, si dhe titullin e avokatit. Për rrjedhojë, ky pretendim lidhet me pamjaftueshmërinë e dokumentacionit mbi të cilin Kuvendi (organet e tij) ka mbështetur vlerësimin e përmbushjes së këtij kushti nga kandidati i zgjedhur Avokat i Popullit.

56. Në analizë të sa më sipër, Gjykata konstaton se ndërsa Kushtetuta dhe ligji organik i Avokatit të Popullit parashikojnë kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët, ato nuk përcaktojnë natyrën ose sasinë e dokumenteve që duhet të paraqiten për këtë qëllim. Me vendimin nr. 2/2025 Komisioni i Ligjeve ka vendosur shpalljen e vakancës për pozicionin e Avokatit të Popullit. Njoftimi për shpalljen e kësaj vakance është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit dhe, sipas tij, propozimi i kandidaturës duhet të përmbajë edhe kërkesën për shprehjen e interesit, CV-në e nënshkruar nga kandidati dhe fotokopje të kartës së identitetit,

diplomën universitare dhe masterin shkencor, librezën e punës ose vërtetime të tjera që provojnë përmbushjen e kriterit ligjor të njohurive dhe veprimtarive të shquara në fushën e lirive e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, si dhe formularët përkatës të deklarimit të plotësuara nga kandidatët, sipas kërkesave ligjore. Referuar këtij njoftimi, në lidhje me kushtin e njohurive në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, kandidatët nuk kërkohet të paraqesin dokumente të përcaktuara, por çfarëdo dokumenti i cili është i aftë të japë të dhëna të mjaftueshme në këtë drejtim. Mungesa e një përcaktimi të shprehur në lidhje me natyrën ose llojin e dokumenteve që duhet të paraqiten për të provuar plotësimin e një kushti ose kriteri të caktuar, nënkupton se ai mund të provohet në forma të ndryshme. Njohuritë dhe përvoja në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit, duke qenë kjo një fushë e gjerë që mbulon aspekte të ndryshme me natyrë specifike, mund të burojnë nga një shumëllojshmëri veprimtarish me natyrë akademike, profesionale, institucionale ose angazhime të tjera në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, konsiderohet se, për shkak të natyrës së këtij kushti, një formë e përcaktuar e një veprimtarie, pra ngurtësimi i dokumentacionit provues mund të mos jetë i përshtatshëm ose i mjaftueshëm. Ndaj, në këtë aspekt nuk merr rëndësi forma dhe lloji i dokumentacionit të paraqitur, por përmbajtja dhe aftësia e tij për të dhënë informacion mjaftueshmërisht të identifikueshëm në lidhje me njohuritë dhe veprimtarinë e kandidatëve, në radhë të parë për deputetët, që të mund të votojnë në mënyrë të informuar dhe, në radhë të dytë, për publikun. Vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nuk mbështetet thjesht në numrin ose llojin e dokumenteve të paraqitura, por në të dhënat që ato përmbajnë, të cilat duhet të vlerësohen nga Kuvendi në tërësinë e tyre.

57. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mungesën e dokumenteve që provojnë plotësimin e këtij kushti nga kandidati i zgjedhur duhet të vlerësohet në raport me tërësinë e dokumentacionit të administruar gjatë procedurës parlamentare. Bazuar në aktet e procedurës parlamentare të administruara në këtë gjykim, Gjykata vëren se praktika dokumentare e paraqitur nga kandidati përmban të dhëna të mjaftueshme në lidhje me plotësimin e kushtit të njohurive dhe veprimtarinë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit. Komisioni i Ligjeve, pasi ka verifikuar dokumentet e paraqitura nga kandidatët dhe pasi ka zhvilluar edhe dëgjesat publike me ta, ka vlerësuar të përmbushur këtë kusht nga të gjithë kandidatët që kanë paraqitur interesin e tyre në këtë procedurë. Siç ka prapësuar edhe subjekti i interesuar, Kuvendi, të dhëna si ajo për licencën e avokatit rezultojnë nga regjistra publikë, lehtësisht të verifikueshëm, siç është Regjistri Kombëtar i Avokatëve i Dhomës Kombëtare të

Avokatisë, kurse të dhëna për angazhime në projektet e organizatave të referuara nga kandidati, përveç dokumentacionit të aplikimit të depozituar në Kuvend (kërkesa për shprehje interesi, CV-ja, lista e publikimeve, libreza e punës dhe lista e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore), përbëjnë, gjithashtu, fakte publike të dokumentuara gjerësisht në media, në publikimet zyrtare të vet këtyre organizatave dhe në burimet akademike, lehtësisht të aksesueshme *online* dhe të identifikueshme. Pavarësisht se për disa prej veprimtarive të deklaruara nuk janë paraqitur dokumente të posaçme (si, për shembull, licenca e avokatit ose vërtetime të angazhimit në organizata të caktuara), kjo mungesë, e marrë veçmas, nuk provon se vlerësimi parlamentar për plotësimin e këtij kushti është kryer pa bazë faktike. Megjithatë, burimet publike mund të shërbejnë si mbështetje për këtë përfundim vetëm për aq sa identifikohen konkretisht dhe mund të verifikohet përmbajtja e tyre. Nuk është detyrë e kësaj Gjykate të përcaktojë se cilat veprimtari kanë një peshë të veçantë, për rrjedhojë se ato duhet të provohen në mënyrë të posaçme, përndryshe ajo do të ndërhynte në vetë hapësirën e vlerësimit të organit të emërtesës, Kuvendit.

58. Për rrjedhojë, në këndvështrim të hapësirës së kontrollit kushtetues, Gjykata arrin në përfundimin se vlerësimi që kandidati i zgjedhur plotësonte kushtin e njohurive në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit nuk rezulton të jetë arbitrar, për sa kohë që aktet e procedurës parlamentare përmbajnë një bazë faktike të mjaftueshme për të bërë të mundur vlerësimin e përmbushjes së këtij kushti nga organi i emërtesës, Kuvendi. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit në drejtim të zgjedhshmërisë së Avokatit të Popullit është i pabazuar.

*C.2. Për papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të Avokatit të Popullit*

59. *Sipas kërkuesit,* në datën 24.10.2025 partia "Nisma Thurje" ka paraqitur kërkesë në gjykatë për regjistrimin e dorëheqjes së Endrit Shabani nga pozicioni i kryetarit të partisë dhe zgjedhjen e kryetarit të ri, gjykim në të cilin ky kandidat ka pranuar se pozicioni i kryetarit të partisë i krijonte kushte papajtueshmërie me funksionin ku po kandidonte. Vendimi i datës 12.11.2025 i gjykatës së shkallës së parë që ka pranuar kërkesën për regjistrimin e dorëheqjes ka marrë formë të prerë më 11.12.2025. Po sipas kërkuesit, me vendimin e datës 21.11.2025, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka vendosur pranimin e dorëheqjes së këtij kandidati nga mandati i këshilltarit dhe me vendimin e datës 23.12.2025 ka vendosur t'i japë mandatin kandidatit të radhës. Kjo, sipas kërkuesit, nënkupton se në datat 31.10.2025 (data e depozitimit të kandidaturës), 12.11.2025 (seanca dëgjimore), 17.11.2025 (miratimi i kandidaturave dhe vlerësimi i kritereve), 09.12.2025 (verifikimi i nënshkrimeve) dhe 11.12.2025 (dita e

zgjedhjes), kandidati Endrit Shabani vazhdonte të figuronte si kryetar i partisë "Nisma Thurje" dhe anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe nëse Komisioni i Ligjeve do të kryente verifikimet e nevojshme, ai do të duhej ta skualifikonte këtë kandidat nga gara.

60. *Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit,* neni 61, pika 4, i Kushtetutës dhe neni 10 i ligjit nr. 8454/1999 i referohen ushtrimit të funksionit dhe jo periudhës së kandidimit. Kandidati ka paraqitur dorëheqjen e parevokueshme nga funksionet politike në kohën e aplikimit, fakt që u bë i njohur edhe gjatë dëgjesës së datës 12.11.2025, edhe pse ky nuk përbën kusht skualifikimi. Komisioni ka administruar dokumentacionin dhe ka kryer verifikimet përkatëse, sipas të cilave kandidati kishte paraqitur dorëheqjen nga funksionet politike përpara aplikimit. Sipas këtij subjekti, nuk është vërtetuar se në momentin juridik të marrjes së mandatit (efektivisht pas datës 18.12.2025 kur u betua), Avokati i Popullit vijonte të ushtronte një funksion politik ose të bënte pjesë në një strukturë politike, në kundërshtim me ndalimet kushtetuese e ligjore. Edhe sikur të ekzistonte një boshllëk kohor formal mes paraqitjes së dorëheqjes dhe regjistrimit administrativ të saj, kjo, sipas Kuvendit, nuk do të sillte pasoja juridike për vlefshmërinë e zgjedhjes, duke qenë betimi momenti relevant kushtetues.

61. Parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërisë përbën garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit dhe evitimin e konflikteve të interesave. Në thelb papajtueshmëria lidhet me ndalimin për të mbajtur dy funksione publike në të njëjtën kohë ose një funksion publik dhe një privat me natyrë ekonomike (ose jo). Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit ose funksionit dhe synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ, në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si element i shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 71, datë 12.11.2025; nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, ndalimi i ushtrimit të më shumë se një funksioni/detyre parashikohet për të garantuar edhe angazhimin e plotë dhe pa rezerva të funksionarit në kryerjen e detyrës së marrë përsipër prej tij, gjë e cila mund të reduktohej ose të bëhej e pamundur për shkak të angazhimit të veçantë që kërkon kryerja e njëkohshme e dy detyrave nga funksionari publik. Kuptimi i papajtueshmërisë qëndron edhe te parimi i shtetit neutral, sipas të cilit organet shtetërore ose pjesë të tyre nuk duhet të jenë të lidhura ose të varura nga interesa ekonomikë. Për papajtueshmërinë, si koncept ndalues i kryerjes së më shumë se një detyre/funksioni, nuk është e rëndësishme nëse funksionari bie në kushtet e përfitimit për shkak të detyrës ose jo apo në konflikt interesi midis detyrës së tij dhe interesave privatë. Vetëm fakti i ushtrimit të dy funksioneve/detyrave (publike-publike, publike-private)

mjafton që ai të konsumojë këtë ndalim (*shih vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Sipas nenit 61, pika 4, të Kushtetutës, Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike dhe as nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale. Kjo dispozitë gjen pasqyrim edhe në përmbajtjen e nenit 10 të ligjit nr. 8454/1999, që parashikon rastet e papajtueshmërisë me funksionin, sipas të cilit Avokati i Popullit ndalohet të bëjë pjesë në parti, organizata politike, të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore e profesionale, të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare. Gjykata vëren se parashikimi i këtyre papajtueshmërive është i lidhur me natyrën dhe pozitën kushtetuese të Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Përmes tyre synohet të garantohet pavarësia dhe paanshmëria e funksionit dhe shmangia e situatave ku ushtrimi i funksioneve ose veprimtarive të tjera mund të krijojë konflikt interesi me përgjegjësitë kushtetuese.

63. Gjykata vëren se, në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të kontribuojnë në shfaqjen dhe përfaqësimin e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të tij në organet e zgjedhura të pushtetit (*shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 11, datë 13.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Pjesëmarrja në një parti politike ose çfarëdo funksioni brenda asaj strukture gjatë ushtrimit të detyrës do të binte ndesh me misionin e Avokatit të Popullit, do të cenonte pavarësinë e institucionit, besimin e publikut (individëve) në paanshmërinë e tij, sikundër mund të vinte në dyshim edhe vetë autoritetin e vendimeve të këtij organi kushtetues, i cili duhet të mbrojë në mënyrë të paanshme të drejtat dhe interesat e ligjshëm të individëve, pavarësisht përkatësisë së tyre politike dhe pavarësisht se cila forcë politike kontrollon veprimtarinë dhe punën e institucioneve të administratës publike.

64. Nga ana tjetër, anëtari i Këshillit Bashkiak, sipas nenit 45 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (*ligji nr. 139/2015*), zgjidhet sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me votim të drejtpërdrejtë, në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet, ose të kandidaturave të propozuara nga zgjedhësit (neni 165 i Kodit Zgjedhor). Funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak, organit përfaqësues të qeverisjes vendore, lidhet me ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse për çështje të

administrimit dhe qeverisjes vendore. Ky funksion, për shkak të natyrës së tij përfaqësuese dhe vendimmarrëse, përbën një funksion politik, ushtrimi i të cilit është, gjithashtu, i papajtueshëm me funksionin e Avokatit të Popullit, në kushtet kur ky i fundit mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të individëve edhe përballë veprimeve ose mosveprimeve të organeve të qeverisjes vendore. Ndalimi kushtetues synon të shmangë konfliktin ndërmjet përgjegjësive që burojnë nga funksioni politik dhe misionit kushtetues të Avokatit të Popullit, duke garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individëve, kur ato cenohen nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike.

65. Për sa u përket këtyre dy shkaqeve të papajtueshmërisë, pjesëmarrjes në parti politike dhe ushtrimit të një funksioni politik, Gjykata konstaton se kandidati i zgjedhur ndodhej në të dyja këto situata përpara zgjedhjes së tij dhe fillimit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, Gjykata vëren se neni 61, pika 4, i Kushtetutës dhe neni 10 i ligjit nr. 8454/1999 i referohen papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit të Avokatit të Popullit dhe jo pazgjedhshmërisë. Për këtë arsye, duhet dalluar ekzistenca e një funksioni ose veprimtarie të papajtueshme në momentin e paraqitjes së kandidaturës nga ndalimi i ushtrimit të njëkohshëm të saj me funksionin kushtetues. Sipas jurisprudencës kushtetuese, papajtueshmëria nënkupton një fakt ose funksion që nuk mund të bashkekzistojë me ushtrimin e funksionit, pra e bën të pamundur ushtrimin e tij. Ndaj, vlerësimi i përmbushjes së kushteve për kandidim dhe i papajtueshmërive me funksionin duhet të bëhet duke mbajtur në konsideratë natyrën e këtyre kërkesave dhe momentin në të cilin bëhen të zbatueshme.

66. Për sa u përket deputetëve, me qëllim verifikimin e ekzistencës së shkakut të papajtueshmërisë, Gjykata ka vlerësuar se momenti i betimit shënon datën e fillimit të ushtrimit të detyrës si deputet dhe jo fillimin e mandatit të deputetit. Pasojat juridike të mandatit fillojnë në momentin që kandidati shpallet deputet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga ky moment ai është i detyruar të plotësojë të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore që lidhen me ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera ose deklarimet lidhur me interesat e tij financiarë. Mandati i deputetit nuk fitohet në Kuvend, ai fitohet gjatë një procesi votimi të përgjithshëm, ku zgjedhësit shprehin lirshëm preferencën e tyre për kandidatët, kurse betimi është një akt që shërben për të deklaruar vullnetin, gatishmërinë, bindjen dhe vendosmërinë e mëtejshme të deputetit të mandatuar për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit në Kuvendin e ri, në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë qëllim (*shih vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

67. Gjykata vëren se pozicioni kushtetues i Avokatit të Popullit është i ndryshëm nga ai i deputetit, për të cilin vetë Kushtetuta, në nenin 71, pika 1, të saj, ka përcaktuar momentin e fillimit të mandatit të tij. Për rrjedhojë, në rastin e Avokatit të Popullit, momenti kushtetues nga i cili fillon ushtrimi i detyrës, pra betimi, është edhe momenti nga i cili verifikohet ekzistenca e shkaqeve të papajtueshmërisë me funksionin kushtetues. Ndërsa zgjedhshmëria ka të bëjë me kushtet që duhet të ketë një individ për t'u zgjedhur në një funksion të caktuar, papajtueshmëria ka të bëjë me ekzistencën e një gjendjeje faktike të lidhur me konfliktin e interesit që pengon ushtrimin e funksionit. Për rrjedhojë, ushtrimi i mëparshëm i një funksioni ose veprimtarie të papajtueshme nuk sjell automatikisht papajtueshmëri gjatë ushtrimit të funksionit kushtetues, nëse ajo gjendje ka përfunduar përpara momentit juridik përkatës.

68. Për sa më sipër, për verifikimin e këtij pretendimi, Gjykata do të ndalet në kronologjinë e ngjarjeve dhe natyrën e efektet juridike të akteve të administruara në procedurën parlamentare dhe në këtë gjykim, me qëllimin për të përcaktuar nëse në momentin e fillimit të ushtrimit të funksionit Avokati i Popullit ishte, njëkohësisht, pjesëmarrës dhe drejtues i një partie politike, si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

69. Gjykata vëren se vakanca për zgjedhjen e Avokatit të Popullit është rishpallur në datën 13.10.2025 nga Kuvendi. Për këtë vakancë në datën 31.10.2025 ka shprehur interesin e tij edhe Endrit Shabani. Në datën 01.10.2025, pra përpara paraqitjes së interesit për të kandiduar, Endrit Shabani ka paraqitur dorëheqjen nga pozicioni i kryetarit të partisë "Nisma Thurje" dhe nga anëtarësia në të, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e datës 16.10.2025 të organit vendimmarrës të kësaj partie (Çentralit), me të cilin është zgjedhur edhe kryetari i ri i partisë. Në datën 24.10.2025 partia "Nisma Thurje" ka paraqitur në gjykatë kërkesë për depozitimin e vendimeve të marra nga organet e saj drejtuese në regjistrin e partive politike. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me vendimin e datës 12.11.2025. Po kështu, në datën 16.10.2025 Endrit Shabani i ka paraqitur Këshillit Bashkiak të Tiranës dorëheqjen nga mandati i anëtarit të këtij këshilli, e cila është pranuar me vendimin e datës 21.11.2025 dhe, në vijim, Këshilli Bashkiak i Tiranës, me shkresën e datës 25.11.2025, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e kësaj vakance.

70. Ndërkohë, në datat 12.11.2025 dhe 13.11.2025, pra pasi ishin paraqitur kërkesat për dorëheqje nga funksionet që kryente kandidati Endrit Shabani, si dhe ishte marrë vendimi i gjykatës për regjistrimin e vendimit në regjistrin e partive politike, Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar seancat dëgjimore me kandidatët dhe në mbledhjen e datës 17.11.2025 ka miratuar

listën e kandidatëve dhe vlerësimin për përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e tyre. Pas përfundimit të procesit parlamentar të verifikimit të plotësimit të kritereve dhe kushteve të kandidimit, në datën 11.12.2025 Kuvendi ka zgjedhur Endrit Shabanin Avokat të Popullit dhe në datën 18.12.2025 ai ka bërë betimin në Kuvend, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 8454/1999.

71. Sipas nenit 9 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", të ndryshuar, regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata e ka miratuar dhe regjistruar atë. Kurse sipas nenit 14 të këtij ligji, dispozitat për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Referuar akteve të administruara (aktet e paraqitura në gjykatë për regjistrimin e vendimit të partisë "Nisma Thurje") rezulton se Endrit Shabani është zgjedhur kryetar i partisë më 04.01.2021 për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, sipas nenit 17, pika 4, të statutit të asaj partie. Ky mandat ka përfunduar më 04.01.2025 dhe ai, sipas dispozitave të statutit, ka vijuar të qëndrojë në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Në datën 01.10.2025 Endrit Shabani ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion dhe nga data 15.10.2025 edhe nga anëtarësia dhe çdo funksion drejtues në parti.

72. Për sa i përket mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak, sipas nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, ai mbaron përpara afatit kur jep dorëheqjen (pika 4, shkronja "b") dhe kjo deklarohet me vendim të Këshillit Bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve (pika 5). Për rrjedhojë, ligji nuk e lidh mbarimin e mandatit të këshilltarit që ka dhënë dorëheqjen me plotësimin e vakancës nga kandidati pasardhës, ndaj procedura e zëvendësimit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak nuk mund të konsiderohet si kusht pengues për mbarimin e mandatit.

73. Për sa më sipër, Gjykata, bazuar në kronologjinë e veprimeve të kryera dhe akteve të miratuara për ndërprerjen/mbarimin e funksioneve të mëparshme me natyrë politike të kryera nga kandidati, vëren se dorëheqjet nga funksioni drejtues dhe anëtarësia në partinë politike, si dhe nga mandati i këshilltarit bashkiak, janë paraqitur përpara kandidimit, zgjedhjes së këtij kandidati si Avokat i Popullit (data 11.12.2025) dhe përpara fillimit të ushtrimit të detyrës (data 18.12.2025). Edhe referuar datës që, sipas kërkuesit, vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për regjistrimin e vendimit të pranimit të dorëheqjes së kandidatit Endrit Shabani dhe zgjedhjes së kryetarit të ri të partisë ka marrë formë të prerë, data 11.12.2025, kjo rrethanë nuk çon në përfundimin se ka ekzistuar një gjendje papajtueshmërie në rastin konkret.

74. Gjykata rithekson se interpretimi i ndalimeve të parashikuara në pikën 4 të nenit 61 të Kushtetutës, të reflektuara edhe në ligjin organik të Avokatit të Popullit, duhet të bëhet në përputhje me qëllimin për të cilin janë vendosur ato. Këto ndalime synojnë të garantojnë që Avokati i Popullit, gjatë ushtrimit të funksionit kushtetues të mos jetë i lidhur ose i ndikuar nga funksione ose veprimtari të tjera që mund të cenojnë pavarësinë dhe paanshmërinë institucionale ose të minojnë besimin e publikut tek institucionet kushtetuese. Për këtë arsye, kontrolli kushtetues verifikon ekzistencën e një gjendjeje reale papajtueshmërie në momentin e fillimit të ushtrimit të funksionit. Gjykata vëren se aktet e administruara në procedurën parlamentare provojnë se përpara kandidimit të tij kandidati ka marrë të gjitha masat për të evituar ekzistencën e ndonjë situate papajtueshmërie në momentin e fillimit të ushtrimit të funksionit kushtetues. Faktet me natyrë kushtetuese që kanë rezultuar gjatë këtij gjykimi nuk provojnë ekzistencën e një shkaku papajtueshmërie pas betimit të Avokatit të Popullit, pra ushtrimin e njëkohshëm të ndonjë funksioni ose veprimtarie me natyrë politike, shtetërore ose profesionale. Për rrjedhojë, për sa kohë që nga aktet e administruara nuk evidentohen shkaqe kushtetuese që vënë në dyshim pajtueshmërinë me funksionin kushtetues, në kuptim të shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

*C.3. Për verifikimin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit*

75. *Sipas kërkuesit,* kandidati nuk ka plotësuar kriterin e mbështetjes me jo më pak se 28 deputetë, sipas nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999 dhe nenit 111, pika 2, shkronjat "ç" dhe "d", të Rregullores së Kuvendit. Sipas tij, në datën 05.12.2025 deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë tërhequr mbështetjen për të gjithë kandidatët për Avokat të Popullit, në respektim të vendimmarrjes së Komisionit të Ligjeve "një deputet mbështet vetëm një kandidat", përfshirë këtu edhe kandidatin Endrit Shabani, për rrjedhojë, në momentin e shqyrtimit të nënshkrimeve nga Komisioni i Ligjeve në datën 09.12.2025, Endrit Shabani nuk ka pasur asnjë deputet mbështetës të kandidaturës së tij, ndaj nuk mund të kualifikohej dhe të kalonte për votim në seancë plenare.

76. *Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit,* propozimi i mbështetur me nënshkrime përbën një veprim që i nënshtrohet afatit dhe kjo mbështetje depozitohet një herë, brenda afatit, duke prodhuar efekt juridik të menjëhershëm në momentin e protokollimit. Pas mbylljes së afatit, as kandidati nuk mund të shtojë mbështetje, as deputeti nuk mund të tërheqë mbështetjen e dhënë. Sipas këtij subjekti, pas këtij momenti kandidati fiton një status procedural të mbrojtur,

ndaj revokimi *post factum* është juridikisht i paefektshëm, pasi synon të ndryshojë me efekt prapaveprues një gjendje juridike të konsoliduar, ndërkohë që deputeti që ka dhënë mbështetjen ruan plotësisht lirinë politike për të votuar pro, kundër ose abstenuar në momentin e votimit në seancë.

77. Gjykata, nisur nga pretendimet e palëve, në ndryshim nga sa ka analizuar më lart për qëllimin e mbështetjes nga 28 deputetë dhe materializimin e saj, për të cilën arriti në konkluzionin se është çështje e organizimit të brendshëm të Kuvendit (*shih paragrafët 37 dhe 38 të vendimit*), tashmë do të verifikojë nga pikëpamja e vlefshmërisë së procedurës së zgjedhjes rregullin e mbështetjes së kandidatëve nga jo më pak se 28 deputetë, pra nëse kjo mbështetje mund të tërhiqet në çdo fazë të procedurës parlamentare apo nëse për ushtrimin e kësaj të drejte nga deputetët ka një pikë fundore, apo, e thënë ndryshe, një afat, kalimi i të cilit pamundëson tërheqjen nga deputeti të mbështetjes së dhënë kandidatit.

78. Sipas nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999, kandidaturat për Avokat të Popullit i paraqiten Kuvendit me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë, të përzgjedhur në radhët e kandidatëve që përmbushin kriteret kushtetuese e ligjore dhe meritën, sipas vlerësimit të komisionit që mbulon çështjet ligjore, në listën e miratuar prej tij. Kurse sipas nenit 111, pika 2, shkronja "d", të Rregullores së Kuvendit (në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj procedure), kandidaturat që marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në këtë nen. Paraqitja e mbështetjes me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë, ndonëse nuk është një rregull i parashikuar nga norma kushtetuese, është një kusht për paraqitjen e kandidaturave seancës plenare, i cili gjen rregullim të shprehur në ligjin organik të Avokatit të Popullit dhe Rregulloren e Kuvendit. Ky kusht është pjesë e korpusit të rregullave procedurale që rregullojnë ushtrimin e kompetencës kushtetuese të Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe synon të sigurojë, nga njëra anë, paraqitjen e disa kandidaturave konkurrente dhe, nga ana tjetër, që në fazën përfundimtare të procedurës të kalojnë ato kandidatura të cilat, përveç përmbushjes së kritereve kushtetuese dhe ligjore, kanë siguruar edhe mbështetjen minimale të kërkuar nga deputetët. Në këtë kuptim, kërkesa për mbështetjen e kandidaturave i shërben organizimit, efektivitetit dhe vijueshmërisë së procedurës parlamentare dhe lidhet me funksionin zgjedhës, pra jo atë ligjvënës të Kuvendit.

79. Gjykata, referuar fakteve me natyrë kushtetuese të evidentuara gjatë këtij gjykimi, vëren se pas rishpalljes së vakancës për pozicionin e Avokatit të Popullit në datën 13.10.2025, kanë paraqitur interesin e tyre për të kandiduar 26 kandidatë, mes të cilëve edhe Endrit Shabani.

Në mbledhjet e datave 12.11.2025 dhe 13.11.2025 Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar seancën dëgjimore me të gjithë kandidatët dhe në mbledhjen e datës 17.11.2025 ka miratuar listën e plotë të kandidatëve, së bashku me vlerësimin për përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Në po atë datë (17.11.2025) kjo listë, së bashku me vlerësimin e Komisionit të Ligjeve për përmbushjen e kritereve kushtetuese dhe ligjore, u është dërguar grupeve parlamentare dhe deputetëve jashtë këtyre grupeve, me qëllim vlerësimin e tyre për mbështetjen e kandidatëve. Si afat për paraqitjen e mbështetjes është lënë data 02.12.2025.

80. Procedura parlamentare për zgjedhjen e Avokatit të Popullit kalon në disa faza të dallueshme, ku faza e parë është verifikimi paraprak i përmbushjes së kritereve kushtetuese dhe ligjore nga Komisioni i Ligjeve, e cila pasohet nga faza e mbështetjes nga jo më pak se 28 deputetë, e nevojshme për kalimin në fazën përfundimtare të votimit të tyre në seancë plenare. Mbështetja e kandidatëve nga deputetët, bazuar edhe në parashikimet e Rregullores së Kuvendit, nënkupton se kandidatura është e aftë që t'i propozohet seancës, pra se ajo plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur për funksionin kushtetues.

81. Në përfundim të afatit (data 02.12.2025) kandidati Endrit Shabani kishte depozituar në Kuvend letrat mbështetëse me nënshkrimet e deputetëve, në total 35 të tillë, nga të cilët një deputet i Partisë për të Drejtat e Njeriut, tre deputetë të Partisë Socialdemokrate, 29 deputetë të Partisë Demokratike, një deputet i Partisë Mundësia dhe një deputet i Partisë Agrare Ambientaliste. Në datën 05.12.2025, 44 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike i janë drejtuar Kryetarit të Kuvendit për tërheqjen e nënshkrimit (propozimit) dhe për pasojë të mbështetjes së tyre për të gjithë kandidatët për Avokat të Popullit, duke revokuar nënshkrimin në të gjitha shkresat e protokolluara prej vetë kandidatëve pas kualifikimit. Sipas tyre, mbështetja është dhënë përpara se Komisioni i Ligjeve të vendoste zbatimin e parimit "një deputet mbështet vetëm një kandidat", ndërkohë që rezultonte se një deputet kishte propozuar/mbështetur më shumë se një kandidat, pavarësisht se deputeti ka vetëm një votë në Kuvend.

82. Në datën 09.12.2025 Komisioni i Ligjeve është mbledhur për shqyrtimin e plotësimit të kushteve ligjore për kandidatët që kanë marrë mbështetjen nga jo më pak se 28 deputetë. Gjatë kësaj mbledhjeje deputetët e pakicës parlamentare kanë pretenduar se asnjë nga kandidatët nuk plotësonte kriterin kryesor për të kaluar për votim në seancë plenare, që është mbështetja nga jo më pak se 28 deputetë. Në përfundim të diskutimeve, Komisioni i Ligjeve ka vlerësuar se vetëm gjashtë kandidatë kanë paraqitur brenda datës 02.12.2025, pra datës së mbylljes së afatit për paraqitjen e firmave mbështetëse, numrin e nevojshëm të deputetëve

mbështetës, për rrjedhojë këta kandidatë do t`i dërgohen për votim seancës plenare. Në lidhje me pretendimin e deputetëve të pakicës parlamentare për tërheqjen e mbështetjes për kandidatët, Komisioni i Ligjeve ka vlerësuar se kjo çështje i takonte për vlerësim dhe vendimmarrje seancës plenare. Në datën 09.12.2025 Kryetari i Kuvendit ka urdhëruar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 11.12.2025, duke përfshirë në rendin e ditës edhe projektvendimin "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit". Me shkresën e datës 11.12.2025, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike (36 deputetë) i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit me kërkesë për tërheqjen e projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke pretenduar se ai ishte nismë e deputetëve të këtij grupi parlamentar. Në seancë plenare është kërkuar nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mospërfshirja në rendin e ditës të projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke u shprehur edhe se kandidaturat zyrtare të kësaj partie janë A.K. dhe B.N. Gjatë seancës plenare ka pasur diskutime dhe debate nga deputetët në lidhje me faktin e mungesës së mbështetjes së kandidaturave të kaluara për votim. Kërkesa për tërheqjen e kësaj çështjeje nga rendi i ditës, pasi është hedhur në votim në seancë, është rrëzuar me shumicën e votave të deputetëve. Në përfundim të procesit të votimit për këtë çështje të rendit të ditës, Kuvendi ka zgjedhur kandidatin Endrit Shabani Avokat të Popullit me 85 vota pro.

83. Gjykata vëren se tërheqja e mbështetjes nga deputetët është paraqitur pas përfundimit të afatit të caktuar për depozitimin e nënshkrimeve dhe pas administrimit të tyre (02.12.2025), ndaj çështja që shtrohet përpara saj ka të bëjë me pasojat e këtij akti në fazat e tjera të procedurës parlamentare. Mbështetja që deputeti i jep një kandidati, sikundër tërheqja e saj janë të drejta që ushtrohen gjatë veprimtarisë parlamentare dhe burojnë nga statusi kushtetues dhe mandati përfaqësues i deputetit, i cili garantohet nga parimi i demokracisë përfaqësuese.

84. Parimi i demokracisë përfaqësuese buron nga neni 1, pika 2, i Kushtetutës, që parashikon se Shqipëria është republikë parlamentare, si dhe nga neni 2, pikat 1 dhe 2, i saj, që sanksionojnë sovranitetin si parim themelor të ekzistencës së shtetit, i cili i përket popullit, që e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Vullneti politik i popullit si bartës i sovranitetit shtetëror bëhet i realizueshëm kryesisht përmes përfaqësimit në Parlament dhe në këtë kuptim Kushtetuta, në nenin 70, parashikon se deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse një deputet, për arsye të

ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

85. Lidhja midis një demokracie efektive politike dhe funksionimit efektiv të parlamentit kërkon gjetjen e ekuilibrit të duhur midis të drejtave të deputetëve individualë të opozitës dhe garantimit të veprimtarisë efektive parlamentare, duke pasur parasysh se duhet të merren në konsideratë edhe të drejtat e pakicës parlamentare, bazuar në konceptet e demokracisë përfaqësuese efektive dhe të shtetit të së drejtës. Në veçanti, duhet të arrihet një ekuilibër, i cili siguron trajtimin e drejtë dhe të duhur të njerëzve që vijnë nga pakicat dhe shmang abuzimin e një pozicioni dominues. Prandaj, me autonominë parlamentare nuk duhet të abuzohet dhe rregullat për funksionimin e brendshëm të parlamentit nuk duhet të shërbejnë si bazë që shumica parlamentare të abuzojë me pozitën e saj dominuese përballë opozitës (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këndvështrim të këtij standardi, Gjykata vlerëson të theksojë edhe se autonomia parlamentare dhe mandati politik (liria e vullnetit) nuk duhet të shërbejnë për të abuzuar me të drejtat e të tretëve.

86. Gjykata, në kuptim të parimit të mandatit të lirë përfaqësues të deputetit, vlerëson se mbështetja e shprehur nga deputeti për një kandidaturë në një fazë të caktuar të procedurës parlamentare nuk mund të interpretohet si detyrim edhe për të ruajtur të njëjtin qëndrim ose mbështetje gjatë gjithë kësaj procedure, pra edhe gjatë fazës së votimit të saj në seancë plenare. Një arsyetim i ndryshëm nuk përputhet me formulën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sipas pikës 1 të nenit 61 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, të drejtat e deputetit që burojnë nga mandati i lirë përfaqësues nuk nënkuptojnë se ai ka të drejtë që të zhbëjë, në çdo moment, pasojat juridike të një veprimi procedural i cili është kryer rregullisht, brenda afatit të caktuar dhe ka përmbushur qëllimin për të cilin është kryer, duke sjellë edhe pasoja juridike për të tretët, siç ishin edhe kandidatët për Avokat të Popullit, të cilët, pas skadimit të afatit, kishin fituar statusin e kandidatit dhe kishin pritshmëri të ligjshme për t'iu nënshtruar votimit. Në këto raste, liria e vullnetit politik ushtrohet nga deputeti përmes votës pro, kundër ose abstenimit.

87. Sipas nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 8454/1999, kandidatura i paraqitet Kuvendit me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë, kurse sipas pikës 6 të kësaj dispozite Avokati i Popullit zgjidhet me tri të pestat e deputetëve. Ndërsa mbështetja nga jo më pak se 28 deputetë

konsiderohet si një kusht për propozimin për votim të një kandidature për një funksion kushtetues, e cila ka plotësuar më parë kushtet dhe kriteret e tjera ligjore, shumica e cilësuar e votave për zgjedhjen në atë funksion përbën materializim të vullnetit politik të Kuvendit. Gjykata, bazuar në parashikimet e ligjit organik të Avokatit të Popullit dhe Rregullores së Kuvendit, vëren se paraqitja e nënshkrimeve nga deputetët është një hallkë e procesit parlamentar, e nevojshme për të bërë të mundur kalimin e kandidaturave të kualifikuara në fazën përfundimtare, atë të seancës plenare. Kjo mbështetje, e cila synon vetëm propozimin e kandidatëve seancës plenare, as nuk përcakton rezultatin e votimit të kandidatëve, as nuk krijon një detyrim për deputetët që e kanë mbështetur atë për të votuar në favor të kandidatit.

88. Mbështetja e deputetëve është një veprim procedural me natyrë parlamentare, që shërben për plotësimin e një kushti të caktuar, ndërsa votimi në seancë përbën ushtrimin e kompetencës kushtetuese të Kuvendit. Për rrjedhojë, për sa kohë që mbështetja është e nevojshme për të bërë të vlefshme kandidaturën, duke e kthyer atë tashmë në një propozim formal për votim në seancë plenare, momenti relevant në të cilin verifikohet plotësimi i kushtit të mbështetjes nga jo më pak se 28 deputetë është ai i përfundimit të afatit të caktuar për paraqitjen e kësaj mbështetjeje, në rastin konkret data 02.12.2025. Pas këtij momenti procedural, mbështetja konsiderohet se ka përmbushur funksionin e saj. Përfundimi i afatit të paraqitjes së mbështetjes nga deputetët përmbyll fazën e paraqitjes zyrtarisht të kandidaturave të vlefshme për votim në seancë plenare dhe nuk lejohet as paraqitja e mbështetjeve të tjera, as tërheqja e mbështetjes së shprehur tashmë. Kjo mënyrë interpretimi, nga njëra anë, i shërben stabilitetit dhe parashikueshmërisë së procedurës parlamentare dhe respekton autonominë e Kuvendit në mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të rregullave të brendshme, si dhe, nga ana tjetër, nuk cenon mandatin përfaqësues të deputetit, i cili ushtrohet përmes shprehjes së vullnetit të lirë gjatë votimit në seancë plenare. Një qëndrim i ndryshëm do të bënte të pasigurt rezultatin e një faze të përfunduar parlamentare dhe do të zhbënte plotësimin e një kushti ligjor të plotësuar tashmë nga kandidati, duke cenuar sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e procedurës edhe në raport me të. Për më tepër, Gjykata rithekson se në rastin konkret nuk bëhet fjalë vetëm për një procedurë të brendshme parlamentare, por ajo sjell efekte edhe te të tretët, në këtë rast kandidatët për Avokat të Popullit.

89. Parimi i autonomisë parlamentare dhe ai i mandatit të lirë të deputetit nuk krijojnë përplasje me njëri-tjetrin për sa kohë që ndërsa njohja e efekteve të mbështetjes së dhënë brenda një afati të caktuar siguron stabilitetin e procedurës, ajo nuk e kufizon deputetin në fazën e votimit përfundimtar, duke qenë ai i lirë të votojë në favor ose kundër kandidatit që ka

mbështetur më parë, pa qenë i detyruar të ruajë qëndrimin mbështetës të shprehur në fazën e propozimit të kandidaturave. Gjykata vëren, gjithashtu, se në procedurat parlamentare për zgjedhjen e funksionarëve publikë, për të cilët kërkohet edhe mbështetja nga një numër i caktuar deputetësh, duhet të dallohet mes vullnetit të individit kandidat për të kandiduar ose për t'u tërhequr nga gara, prej mbështetjes së kërkuar për paraqitjen zyrtarisht të propozimit në seancë plenare. Kandidimi është shprehje e vullnetit të vet individit për të marrë pjesë në procedurë, ndërsa mbështetja nga deputetët i shërben zyrtarizimit të kandidaturës, pra kalimit të saj në fazën përfundimtare të procedurës. Në këtë kuptim, pranimi i tërheqjes së mbështetjes nga deputetët pas përfundimit të afatit procedural që i bën të vlefshme kandidaturat, për sa kohë që ka prodhuar efekte procedurale për kandidatin, mund të kishte kuptim vetëm nëse do të bazohej në ndonjë akt tërheqjeje të vet kandidatit, si i vetmi shkak për përfundimin e procedurës në këtë fazë, për atë kandidat.

90. Gjykata vlerëson se administrimi nga Komisioni i Ligjeve i listës me nënshkrimet mbështetëse përbën një akt formal me efekt të menjëhershëm, që sjell pasoja procedurale në drejtim të vlefshmërisë së kandidaturës. Verifikimi nga Komisioni i Ligjeve, i cili në këtë fazë kufizohet në kontrollin e përmbushjes së kushtit ligjor për numrin minimal të deputetëve mbështetës, shërben për të përcaktuar nëse kandidatura mund të kalojë në fazën e votimit. Në këtë kuptim, me përfundimin e afatit për paraqitjen e mbështetjes dhe verifikimin e plotësimit të këtij kushti, mbështetja e deputetëve e ka përmbushur funksionin e saj në procedurën e zgjedhjes. Për rrjedhojë, në mungesë të një parashikimi normativ që i njeh tërheqjes së mëvonshme të mbështetjes pasoja juridike për kualifikimin e kandidaturës, një tërheqje e tillë nuk mund të cenojë efektet procedurale të prodhuara tashmë, pasi një përfundim i kundërt do të cenonte sigurinë juridike, stabilitetin dhe parashikueshmërinë e procedurës parlamentare.

91. Thënë sa më sipër, Gjykata vlerëson se në datën 05.12.2025, kur deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë paraqitur tërheqjen e tyre nga mbështetja e kandidatëve, kishte përfunduar zyrtarisht afati për paraqitjen nga kandidatët të listave mbështetëse, të cilat i ishin dërguar Komisionit të Ligjeve. Për rrjedhojë, mbështetja e depozituar kishte prodhuar efektet e saj procedurale, ndaj tërheqja e mëvonshme e mbështetjes pas kalimit të kësaj faze nuk mund të sjellë më pasoja të detyrueshme në procedurën vijuese parlamentare. Për më tepër, si në Komisionin e Ligjeve, ashtu edhe në seancë plenare këta deputetë kanë vënë në diskutim mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave të Rregullores lidhur me momentin procedural të tërheqjes së mbështetjes së tyre. Seanca plenare, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën për tërheqjen e kësaj çështjeje nga rendi i ditës, e ka rrëzuar

atë. Gjykata vlerëson se procedura e ndjekur nga Kuvendi ka respektuar dallimet ndërmjet fazave të ndryshme të procedurës parlamentare, pa cenuar parimin e mandatit të lirë përfaqësues. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë se kandidatura e zgjedhur ka siguruar brenda afatit procedural numrin minimal të mbështetjes nga deputetët, se tërheqja e mbështetjes është paraqitur pas përfundimit të këtij afati dhe se deputetët kanë ruajtur lirinë për të shprehur vullnetin e tyre gjatë votimit të kandidaturave në seancën plenare, Gjykata arrin në përfundimin se në procedurën parlamentare të zgjedhjes së Avokatit të Popullit nuk konstatohet cenimi i parimeve ose të normave kushtetuese. Për këto arsye, dhe pretendimi i kërkuesit në drejtim të procesit parlamentar të zgjedhjes së Avokatit të Popullit është i pabazuar.

92. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "e" dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

**V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 29.09.2026**

**Shpallur më 20.11.2026**